

VENDIM
Nr.883, datë 22.12.2004

PËR TRAJTIMIN E NJË PJESE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE MBROJTJES SË DËSHMITARËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e sektorit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë në Drejtorinë e Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve e të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, përfitojnë shtesë mbi pagë për gradë, për vështirësi vendi pune dhe shërbimi, në masën 21 600 (njëzet e një mijë e gjashtëqind) lekë në muaj, për gradën nënkomisar, 26 800 (njëzet e gjashtë mijë e tetëqind) lekë/muaj, për gradën komisar dhe 30 800 (tridhjetë mijë e tetëqind) lekë/muaj, për gradën kryekomisar.

2. Punonjësve të sektorit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë në Drejtorinë e Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve e të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, që përgatisin, ndjekin dhe zbatojnë masa të posaçme mbrojtjeje, për punë cilësore, angazhim e rezultate të larta në luftën ndaj krimit të organizuar, gatishmëri dhe për kryerjen e detyrave në shërbime të veçanta, t’u jepet shpërblim deri në 6 (gjashtë) paga mujore në vit.

Masa e shpërblimit miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve e të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, deri në dy paga mujore, në fund të çdo 6-mujori, dhe me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, deri në 6 (gjashtë) paga mujore në vit.

3. Për nevoja shërbimi punonjësi i sektorit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë pajiset me pasaportë shërbimi, si dhe i krijohen lehtësi të tjera në marrjen e vizave.

4. Punonjësit të sektorit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, që ka nevojë për strehim, i jepet kredi me kushte të favorshme, sipas vendimit nr.102, datë 5.3.1999 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politike dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” ose i kompensohet qiraja mujore e banesës, deri në masën 80 për qind të vlerës. Çmimi mesatar i qirasë së banesës të jetë ai i përcaktuar, çdo vit, nga Instituti i Statistikës (INSTAT).

Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e kredisë për strehim apo kompensimi për qira mujore e banesës përcaktohet me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

5. Lista e punonjësve, që do të trajtohen me kredi, miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, ndërsa lista e punonjësve, që do të kompensohen për qiranë e banesës, miratohet nga Ministri i Rendit Publik.

6. Pika 3 e vendimit nr.50, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet, që i shkakohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, nuk zbatohet për punonjësit e sektorit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

7. Efektet finansiare që rrjedhin nga ky vendim, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

8. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.11.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

